

---

**OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A**

Tiranë, më 05.06.2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

- 1. OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje/pjesësh për mirëmbajtjen 1-vjeçare të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare” për nevoja të Komandës së Forcës Detare.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):**

Pjesë të pajisjeve radio dhe radar 32352100-6, Pjesë këmbimi dhe pajisje radar 32352200-7

**VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS:**

Fondi limit: **19,596,113** (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e trembëdhjetë) lekë pa tvsh ose **205,647.1** (dyqind e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë pikë një) EURO pa tvsh.

**\*Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 04.06.2026, me kurs këmbimi 95.29(nëntëdhjetë e pesë pikë njëzet e nëntë) lekë.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Komanda e Forcave Detare janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 "Formulari permbledhes i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", te Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik".

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit objekt prokurimi**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është e mbështetur në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është mbi vlerën e kufirit të lartë monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” AK nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së përlogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.*

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: .....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik,

*të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogarit të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

#### **2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me:

a) **Standardin ISO 9001** ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të

zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për këtë pajisje është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit j dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike/broshurë të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike/broshurë nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedën teknike/broshurën ka disa avantazhe pasi siguron besueshmëri të informacionit. Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Në këto forme reduktohet rreziku i mashtrimeve ose i ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfutues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e afatit të garancisë për pajisjet objekt prokurimi konform përcaktimit të bërë në specifikimet teknike duke filluar nga koha e lëvrimit të tyre dhe gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve që vijnë për shkak të prodhimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se artikujt e ofruar janë cilësorë dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të difekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë** me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të mallit në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim.**

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.



## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike :**



*Përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike është grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Komanda e Forcave Detare për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar. Specifikimet teknike janë si më poshtë vijon;*



### **SPECIFIKIMET TEKNIKE JANË SI MË POSHTË VIJON:**




Nr.	Emërtimi materialit	Specifikimet Teknike, Përmasat, Fuqia (Kodi nëse ka) dhe Destinacioni i përdorimit	Foto e Artikullit
<b>PJESË KËMBIMI PËR SISTEMIN E INTEGRUAR TË VËZHGIMIT TË HAPËSIRËS DETARE</b>			
<b>I. PAJISJE/PJESË PËR RADAR DHE MJEDISËT E TRANSMETIMIT</b>			




1	Reduktor 19ft	<p><b>Model :</b> 19 FT</p> <p><b>Part no:</b> EM012522</p> <p>Seria: MAS (Helical In-line)</p> <p>Montimi: F-type (Flange)</p> <p>Boshti daljes: 25mm diametër</p> <p>Shpejtësia: afërsisht 1400-1650 RPM</p> <p>Pesh: afërsisht (10kg)</p>	
2	Reduktor 21FT	<p><b>Model :</b> 21 FT</p> <p><b>Part no:</b> EM012552</p> <p>Tipi: Bevel-helical (kënd 90°)</p> <p>Seria: A412 (Bonfiglioli)</p> <p>Raporti (i): 28.3</p> <p>Montimi: B7 (flanxhë anësore)</p> <p>Flanxha motorike: P100 (IEC 100)</p> <p>Boshti dalës: Ø45 mm (h6 / G7 tolerancë)</p> <p>gjatësi ≈ 80 mm</p> <p>Boshti hyrës: ≈ Ø28 mm (tipik për këtë konfigurim)</p> <p>Flanxha motorike: IEC 100</p> <p>Pozicion montimi: universal (horizontal/vertikal)</p>	



3	Encoder	<p><b>Model :</b> Kubler</p> <p><b>Part no:</b> EM020560</p> <p><b>Tipi:</b> 8.5000.0311.4096.s028</p> <p><b>Rezolucioni:</b> 4096 pulse për rrotullim</p> <p><b>Rezolucioni angular:</b> 0.088°</p> <p><b>Tipi i sinjalit:</b> RS422</p> <p><b>Tension furnizimi:</b> 5-30 VDC 90mA</p> <p><b>Shpejtësia maksimale:</b> deri 12,000 rpm</p> <p><b>Mbrojtja:</b> IP65-IP67 Sensor pozicioni dhe rrotullimi që përdoret për të përcaktuar azimuth-in e antenës gjatë rrotullimit.</p>	
4	Analogue Board	<p><b>Model :</b> ITS-26000</p> <p><b>Part no:</b> EB085200</p> <p><b>Tipi:</b> Radar Analog Processing Board</p> <p><b>Funksioni:</b> Procesim video&amp;amplifikim</p> <p><b>Fuqia e amplifikimit:</b> 40-80Db</p> <p><b>Video Bandwith:</b> deri 20MHz</p> <p><b>Input signal:</b> radar IF</p> <p><b>Output:</b> analog radar video</p>	

		<p><b>Furnizimi:</b> <math>\pm 12V / + 5V</math> DC</p> <p>Është kartë elektronike analoge e përpunimit të sinjalit radar nga RF në video radar.</p>	
5	Magnetron	<p><b>Model :</b> MG5222</p> <p><b>Part no:</b> EV050452</p> <p>Tipi: Magnetron me pulsime</p> <p><b>Fuqia:</b> 25Kw</p> <p><b>Frekuenca:</b> X-Band, 9345-9405 Ghz</p> <p>Instalohet në bllokun e radarit.</p> <p><b>Pesha:</b> rreth 1.5</p> <p><b>Tensioni i anodës:</b> 7.5 – 8.5 Kw</p> <p><b>Dalja RF:</b> Me valëkalues UG-40B</p> <p>Përdoret si burimi kryesor i energjisë mikrovalore në radarët detarë X-Band.</p>	
6	Modulator Board	<p><b>Model :</b> MDL32520</p> <p><b>Part no:</b> EB080221</p> <p>Input DC: +24V DC (standard naval)</p> <p>+5V / +12V për logjikë</p> <p>Konsumi: ~10–25 W</p> <p>Pulse Width (<math>\tau</math>): 0.05 <math>\mu s</math> – 1 <math>\mu s</math> (short range)</p>	

		<p>deri 5 <math>\mu</math>s (long range)</p> <p>Pulse Repetition Frequency: 500 Hz-3000 Hz</p> <p>Rise time: &lt; 50 ns</p>	
7	Dehidrator	<p><b>Model :</b> Andrew MR050-81046</p> <p><b>Part no:</b> AE990021-R1</p> <p>High-pressure Desiccant Dehydrator, 19 in rack mountable, 3.0-5.0 psig, 240 V AC, 50/60 Hz</p> <p>Airflow 300l/h</p> <p>Dew point <math>\leq</math> -45°C</p> <p>Redukton lagështinë në waveguides dhe modulët RF për të parandaluar kondesimin dhe degradimin e performancës së radarit.</p>	
8	Power supply (Ushqyes)	<p><b>Model :</b> Emersson Astec Imp4-1Q0-1D0-1E0-4LL00</p> <p><b>Part no:</b> AA026553</p> <p>Montimi: Chassis mount</p> <p>Dimensione: 254 × 127 × 63.5 mm</p> <p>Daljet tipike: Output 1: 24V, Output 2: 3.3V</p> <p>Output 3: 5V, Output 4: 12V, Output 5: 12V</p> <p>Tension hyrës: 85 – 264 VAC, 120 – 300 VDC</p> <p>Frekuenca: 47 – 440 Hz</p> <p>Power Factor (PFC): ~0.99</p>	

9	Limiter	<p><b>Model :</b> B3LT1649</p> <p><b>Part no:</b> EX042452</p> <p>Frekuenca operative: 9.2 – 9.5 GHz</p> <p>Fuqia maksimale (hyrje): deri 25kW</p> <p>Humbjet në hyrje (RX mode): &lt; 0.5 dB</p> <p>Fuqi rrjedhje (TX → RX): &lt; 10 mW</p> <p>Koha e rikuperimit: &lt; 100 ns</p> <p>VSWR: &lt; 1.5:1</p>	
10	Front End	<p><b>Model :</b> B3RX1640</p> <p><b>Part no:</b> EX061102</p> <p>Frekuenca: 9.2 – 9.5 GHz</p> <p>Zhurma: 2 – 3 dB</p> <p>Gain total: 20 – 35 dB</p> <p>Diapazoni dinamik: &gt; 80 dB</p> <p>Fuqia hyrese: ~0 dBm (pas limiter)</p>	
11	Noise generator/detector	<p><b>Model :</b> 3NG1641</p> <p><b>Part no:</b> EX500702</p> <p>Frekuenca: X-Band</p> <p>Noise output (ENR): 10 – 20 dB</p> <p>Stabilitet: ±0.5 dB</p> <p>Detector range: -60 dBm → 0 dBm</p> <p>Accuracy: ±1 dB</p>	

12	Circulator	<p><b>Model</b> : NJC3901B/ B3JC1649</p> <p><b>Part no:</b> EX070552</p> <p>Frekuenca: 9.2 – 9.5 GHz</p> <p>Humbjet hyrës: &lt; 0.3 dB</p> <p>Izolimi: &gt; 20 – 25 dB</p> <p>VSWR: &lt; 1.3:1</p> <p>Trajtimi i fuqisë:deri 30 kW peak~100 W average</p>	
13	Circulator	<p><b>Model</b> : NJC3901B/ B3JC1649</p> <p><b>Part no:</b> EX07055-R1</p> <p>Frekuenca: 9.2 – 9.5 GHz</p> <p>Humbjet hyrës: &lt; 0.3 dB</p> <p>Izolimi: &gt; 20 – 25 dB</p> <p>VSWR: &lt; 1.3:1</p> <p>Trajtimi i fuqisë:deri 30 kW peak~100 W average</p>	
14	Safety Switch (Çelës Sigurie)	<p><b>Model</b> : SSA-10000</p> <p><b>Part no:</b> AA203501</p> <p><b>Temperatura:</b> -5 — 40 °C</p> <p><b>Lagështia:</b> ≤50% rH (at +40 °C)</p> <p>≤90% rH (at +20 °C)</p> <p>(jo- kondensuese)</p>	

		<p><b>Karakteristikat kryesore:</b> 90° switching angle</p> <p><b>Protection standard:</b> IP65 (according to EN 60529)</p>	
15	Ushqyes Radio-Rele për	<p><b>Model :</b> FPS 48V 2Kw 230VAC</p> <p>Hyrja AC : 100 – 250V / 12Amaks</p> <p>Frekuenca : 45 – 66Hz</p> <p>AC fuse : E jashtme</p> <p>Dalja DC : 60Vmax / 41.6Amax</p> <p>Dimensionet WxHxD (mm) 482.5 x 44,1 x 250 mm</p> <p>2 rectifier</p> <p>Për vendosje në rack 1U</p>	
16	Bateri për radio - rele	<p><b>Model :</b> 12V – 100Ah</p> <p>Thin Plate Pure Lead (TPPL) technology</p> <p>Dimensioni (mm) : L 395 W 108 H 288</p> <p>Terminal : M8 F</p> <p>Jetëgjatësia : 10 vjet</p>	

Në zbatim të procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje pajisje/pjesësh për mirëmbajtjen 1-vjeçare të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD)”, grupi i punës i ngritur pranë AK Përfitues Komandës së Forcave Detare pasi shqyrtoi dokumentacionin teknik dhe nevojat operacionale, argumenton mbi specifikimet teknike se:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, konkretisht: Neni 36, pika 3 dhe 4, ku përcaktohet se:

Specifikimet teknike nuk duhet të referojnë marka, prodhues apo burime specifike që favorizojnë operatorë të caktuar;

Përfundimisht, lejohet referimi i tillë kur objekti i kontratës nuk mund të përshkruhet ndryshe në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme;

VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, konkretisht:

Neni 78, pika 2, ku përcaktohet se specifikimet teknike duhet të garantojnë konkurrencë të drejtë, por edhe funksionalitetin dhe përputhshmërinë teknike të sistemit.

Pas analizimit të specifikimeve teknike (nr. rendor 1–14), rezulton se këto pajisje/pjesë:

- Janë komponente kritike të radarit tip SEAFALCON, pjesë integrale e SIVHD;
- Janë të projektuara dhe prodhuara specifikisht për këtë sistem radarik, me parametra unikë teknikë;
- Sigurojnë funksione jetike si:
  - o gjenerimi dhe transmetimi i sinjalit radar (magnetron, modulator, front-end);
  - o përpunimi i sinjalit (analogue board);
  - o mbrojtja e marrësit (limiter, circulator);
  - o matja e pozicionit (encoder);
  - o ruajtja e kushteve optimale të punës (dehidrator);
  - o furnizimi me energji dhe kontrolli i sigurisë.

Për pjesët nga nr. 1 deri në nr. 14, grupi i punës konstaton se:

Prodhuesi është unik (OEM)

Këto pjesë prodhohen ekskluzivisht nga kompania prodhuese e radarit dhe janë:

të integruara në mënyrë të dedikuar në arkitekturën e sistemit;

të papërshtatshme për zëvendësim me produkte standarde të tregut.

Papajtueshmëria teknike e alternativave

Çdo përpjekje për përdorimin e pjesëve “ekuivalente” do të sillte: mos-përputhje në frekuenca, sinjale dhe ndërfaqe; degradim të performancës radarike (range, detection, stabilitet); rrezik për dëmtim të komponentëve të tjerë të sistemit.

Kërkesa për ndërveprueshmëri dhe integrim

Sistemi radarik është një sistem i mbyllur, ku: çdo komponent është i kalibruar dhe testuar për punë të përbashkët;

ndërhyrjet me komponentë jo-origjinale çënojnë funksionimin e të gjithë zinxhirit radarik.

Siguria operacionale

Pajisje si: magnetroni (burimi RF), limiter-i dhe circulator-i (mbrojtja e marrësit), safety switch janë kritike për sigurinë e personelit dhe pajisjes.

Mirëmbajtja dhe garancia teknike

Përdorimi i pjesëve jo-origjinale: anulon garancinë teknike të sistemit, e bën të pamundur suportin teknik nga prodhuesi.

Në përfundim, grupi i punës argumenton se:

Referimi i modeleve dhe prodhuesit për pjesët nr. 1–14 është i domosdoshëm dhe i justifikuar plotësisht, pasi:

nuk ekziston mënyrë tjetër e saktë dhe funksionale për përshkrimin e tyre; këto pjesë janë specifike dhe të pazëvendësueshme për sistemin ekzistues;

Ky rast përbën një rast përjashtimor, në përputhje me:

Nenin 36, pika 3 dhe 4 të Ligjit nr. 162/2020; Nenin 78, pika 2 të VKM nr. 285/2021.

Për këtë arsye, përdorimi i referencave të drejtpërdrejta për markë/model është: teknikisht i domosdoshëm; ligjërish i lejuar; i justifikuar për garantimin e funksionalitetit dhe sigurisë së sistemit SIVHD.

**Shënim:** Ne lidhje me pajisjet me numrin rendor 15 dhe 16 për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur, pranohet edhe “ekuivalenti” i tyre. Ekuivalenca duhet të garantojë përputhshmëri të plotë funksionale, elektrike dhe mekanike me sistemin ekzistues.

Afati i garancisë për materialet të kërkuara të jetë 1 vit (një) duke filluar nga koha e lëvrimit të tyre.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, mbazuar në nevojat e autoritetit kontraktor përfitues kurse specifikimet teknike janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Komanda e Forcave Detare. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

- *Dokumentat e tenderit*
- *Specifikimet teknike*

**NJËSIA E PROKURIMIT**